



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 752/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 07.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Shaga” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-80916-07-27-2018 me objekt: “Mobilim i salles se Teatrit Bylis Fier”, me fond limit 7 499 600 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 09.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Riap-05” sh.p.k.

Ankimues:

“Shaga” sh.p.k
Rruga “H.Pepa”, Ish Parku Industrisë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier,
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi” Nr.15
Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.07.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr.REF-80916-07-27-2018 me objekt: “*Mobilim i salles se Teatrit Bylis Fier*”, me fond limit 7 499 600 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 09.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.

II.2. Në datën 03.09.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si vijon:

1. “Erzeni/Sh” sh.p.k 4.300.000 lekë, skualifikuar
2. “Erald” sh.p.k 5.960.000 lekë, skualifikuar
3. “Shaga” sh.p.k 6.672.000 lekë, skualifikuar
4. “Bold” sh.p.k 6.739.000 lekë, skualifikuar
5. “Muca” sh.p.k 6.832.410 lekë, skualifikuar
6. “Riap-05” sh.p.k 7.270.800 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “Shaga” sh.p.k rezulton i skualifikuar me argumentin e KVO-së si më poshtë vijon:

“Oferta refuzohet pasi bazuar ne procesverbalin nr 7132/5 date 29.08.2018, mostrat e paraqitura nga ana juaj nuk perputhen me kerkesat e Autoritetit Kontraktor dhe ne baze te specifikimeve teknike te kontrolluara nga komisioni oferta juaj nuk eshte shpallur fituese.”

II.3. Në datën 07.09.2018 operatori ekonomik “Shaga” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

“[...] Në datën 22.08.2018, në orën 15:46, në adresën tonë në APP na ka ardhur mesazhi me klasifikimin e kompanive pjesëmarrëse në këtë procedurë si dhe kualifikimin e ofertës sonë për dokumentacionin e kërkuar. Gjithashtu po në datën 22.08.2018 na ka ardhur mesazhi nëpërmjet mesazheve elektronike “Njoftim për paraqitje mostre”, në datën 27.08.2018, ora 10:00.

Nisur nga rastet ku vetë ligji për prokurimet publike përcakton dy momente në të cilat mund të paraqitet mostër në procesin e prokurimit, të cilat janë:

- 1. Momenti i mbylljes së ofertave, dhe*
- 2. Momenti i lidhjes së kontraës,*

Dhe kjo për faktin që në të dyja rastet, cdo operator ekonomik pjesëmarrës, ka kohën e mjaftueshme të përgatisë mostrën në përputhje me specifikimet, në një afat minimal 10 ditë (si në rastin e procedurave Kërkesë për Porpozim) dhe më tepër për Procedurën e Hapur etj.

Vendosja e këtij krireri në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit (Kriteret e Përgjithshme dhe Kriteret e Vecanta për Kualifikim), aq më tepër në rubrikën “Shënime” të saj, e cila është thjesht një direktivë orientuese dhe aspak detyruese për operatorët pjesëmarrës në procedurën konkurruese, e bën këtë kërkesë të pavlefshme dhe jo kusht skualifikues për operatorët konkurrues. Ajo që duhet të theksojmë është edhe fakti që, afati minimal që duhej tu vendosej operatorëve ekonomikë konkurrues në këtë procedurë, për paraqitjen e mostrës, duhej të ishte edhe afati minimal që ka përcaktuar ligji prej 10 ditë.

Gjithsesi shoqëria “Shaga” sh.p.k, në datën e caktuar në mesazhin elektronik, u paraqit pranë AK me mostrën e kërkuar për tu dorëzuar, së bashku me katalogun e materialeve 100% lëkurë, në mënyrë që AK të kishte mundësi zgjedhje të tyre.

Ditën e caktuar për dorëzimin e mostrave, pranë AK u paraqitën kompanitë si më poshtë:

- 1. Shoqëria “Shaga” sh.p.k*
- 2. Shoqëria “Erzeni/Sh” sh.p.k*
- 3. Shoqëria “Riap-05” sh.p.k. (Theksojmë se përfaqësuesi i shoqërisë “Riap-05” sh.p.k nuk provoi dhe nuk paraqiti asnjë dokument autorizues për të vepruar në emër të shoqërisë “Riap 05” sh.p.k, dokument ky që lidhet drejtpërdrejtë me legjitimimin e përfaqësuesit të shoqërisë “Riap-05” sh.p.k nëpërmjet këtij personi. Dhe nisur nga sa sqarua më lart, edhe mostra e dorëzuar nga ky person, kurrsesi nuk mund të merrej në dorëzim apo konsideratë nga AK, pasi ky individ nuk paraqiti asnjë dokument që të vërtetonte se vepronte në emër të shoqërisë. Ky fakt është shënuar edhe në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mostrave nga KVO, në datën 27.08.2018.*

Pas dorëzimit të mostrave, një shkelje tjetër e procedurës së ndjekur nga KVO, ka qënë edhe shtyrja e afatit të vlerësimit të mostrave dhe mosbërja e tij në momentin e dorëzimit, duke na detyruar ne kompanive pjesëmarrëse që të paraqitemi edhe një ditë tjetër dt.29.08.2018, ora 10.00. Të gjitha këto kërkesa dhe shtyrje afatesh janë shoqëruar me kosto të tepërta ekonomike e financiare për shoqërinë

tonë, duke na rënduar financiarisht me kosto shtesë të panevojshme dhe kjo vetëm për mungesë korrektësie dhe profesionaliteti, për qëllime tendencioze nga ana e KVO-së për bërjen e vlerësimit. Të gjitha këto veprime të realizuara nga KVO-ja kanë qënë të padrejta, jo konform legjislacionit në fuqi, tendencioze dhe me qëllim skualifikimin e ofertës sonë dhe kualifikimin e ofertës së dorëzuar nga shoqëria “Riap 05” sh.p.k, mostra e së cilës u mor në dorëzim edhe pse nuk kishte asnjë dokument legjitimues të personit që u paraqit për ta përfaqësuar.

Në datën 29.08.2018 u paraqitëm pranë AK, në adresën e përcaktuar sipas njoftimit të dt.22.08.2018 dhe na u komunikua gojarisht, që vlerësimi i mostrave ishte bërë nga KVO dhe KVO ka dalë në konkluzionin që të gjitha mostrat e paraqitura kishin devijime nga produkti i kërkuar nga AK për tu dorëzuar. Dhe kanë përcaktuar që mostra e “Riap-05” sh.p.k është ajo që do të shpallet fituese. Ky konkluzion i KVO-së është shkruar në procesverbalin e datës 29.08.2018 dhe është firmosur prej tyre, duke e kompromentuar këtë procedurë dhe në shkelje të cdo akti ligjor për prokurimet publike në fuqi. Ligji nr. 9643, dt 20.11.2006 “Për prokurimet publike”, i ndryshuar, i ka përcaktuar qartë mënyrën, vlerësimin dhe procedurën e shpalljes së fituesit për procedurat e prokurimit. Komentet e KVO-së ishin aspak profesionale dhe qartazi emocionalisht të ndikuara për shpalljen fituese të shoqërisë “Riap-05” sh.p.k.

Në datën 03.09.2018, në adresën tonë në APP na ka ardhur klasifikimi i shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedurë dhe skualifikimi i ofertës së dorëzuar nga shoqëria “Shaga” sh.p.k me arsye të pabaza dhe aspak të vërteta. Sipas këtij klasifikimi dhe arsyesimit të KVO-së, shoqëria “Shaga” sh.p.k është skualifikuar nga kjo procedurë konkurruese me arsyetimin e mëposhtëm.

Arsyeja e paraqitur nga KVO-ja për skualifikimin e ofertës sonë ishte si më poshtë:

“Oferta refuzohet pasi bazuar ne procesverbalin nr 7132/5 date 29.08.2018, mostrat e paraqitura nga ana juaj nuk perputhen me kerkesat e Autoritetit Kontraktor dhe ne baze te specifikimeve teknike te kontrolluara nga komisioni, oferta juaj nuk eshte shpallur fituese.”

Ju bëjmë me dije se kjo arsye e paraqitur nga KVO-ja nuk qëndron dhe po përdoret nga KVO-ja vetëm si justifikim për të gjetur arsye të paqena pa patur mundësinë të gjejë dot asnjë arsye reale dhe konkrete për skualifikimin e ofertës sonë. Shoqëria “Shaga” sh.p.k e ka dorëzuar mostrën pranë AK-së sipas kriterëve të vendosura në dokumentat e tenderit, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktura, madje në një cilësi akoma më të mirë. Ky fakt mund të verifikohet mjaft lehtë duke e kontrolluar dhe rivlerësuar mostrën e dorëzuar nga ana jonë.

Gjithashtu ngremë hipotezën që edhe sikur të ekzistonte ndonjë devijim për një përmasë thjesht plotësuese dhe aspak të rëndësishme e vendimtare për vlefshmërinë e ofertës, të parashikuar nga shtojca 8, kriteret e vecanta të kualifikimit, sic është në këtë rast veshja me multistrate e shpinores dhe ulesës dhe trashësia e mbështetëses me 4cm më shumë, që janë lehtësisht të rregullueshme.

Bazuar në nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 4, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili shprehet si më poshtë:

“4.Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.”

Nisur nga kjo, në një kohë kur shoqëria jonë i ka hedhur në sistem të gjitha dokumentat e kërkuara sipas kriterëve të vendosura në dokumentat e tenderit, pas njoftimit nga AK, ka dorëzuar në përputhje me afatet dhe dokumentacionin ligjor shoqëruës, mostrën me

- Përmasa, përbërje, cilësi jo vetëm në përputhje me dokumentat e tenderit, por shumë herë më të mira dhe cilësore në materiale, në përputhje me standartet dhe kriteret kombëtare dhe ndërkombëtare që kërkohet të plotësohen për këtë produkt objekt prokurimi, rrjedhimisht, veshja me multistratë e shpinorës dhe ulesës dhe trashësia e mbështetëses me 4 cm më shumë, dhe mbi të gjitha që janë lehtësisht të rregullueshme, nuk ndikojnë aspak në cilësinë dhe përdorimin e produktit që kërkohet të dorëzohet.

Sipas skicave dhe shënimeve të KVO-së që na u vendosën në dispozicion në datë 29.08.2018 si dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë krahasuese po paraqesim më poshtë diferencat dhe përputhjet e specifikimeve teknike me matjet në vend të bëra nga KVO.

| Nr. | Emërtimi i përmasës | Shaga Vlera | Riap Vlera | AK Specifikimet në DST, Vlera e kërkuar | Rezultati/ përputhshmëria me e afërt |
|-----|------------------------------|------------------|-------------------|--|--|
| 1 | Gjërësia e shpinorës | 45 cm | 44 cm | 58 cm | Shaga |
| 2 | Gjerësia e krahëve | 9.5 cm | 8 cm | 9 cm | Shaga |
| 3 | Lartësia dysheme-krah | 59 cm | 59 cm | 61 cm | Të dyja |
| 4 | Veshje lëkure | Lëkure | Inkelit | Lëkurë | Shaga |
| 5 | Veshje multistate shpinore | Veshje me lëkurë | Multistrade | Multistrade | Riap-05 |
| 6 | Këmba hekur | Po | Po | Po | Të dyja |
| 7 | Lartësia e mbështetëses | 70 cm | 75 cm | 45 cm | Të dyja |
| 8 | Trashësia e mbështetëses | 9 cm | 10 cm | 13.2 cm | Riap-05 |
| 9 | Gjërësia e ulesës | 45 cm | 42 cm | 44 cm | Shaga |
| 10 | Gjërësia totale | 54 cm | 52 cm | 72 cm | Shaga |
| 11 | Veshje e ulesës | 4 cm plastik | 0.8cm multistrade | Multistrade | Riap-05 |
| 12 | Trashësia e ulesës | 13 cm | 16 cm | 13.2 cm | Shaga |
| 13 | Lartësia dysheme-ulëse | 27 cm | 23 cm | 40 cm | Shaga |
| 14 | Gjerësia e këmbës metalike | 25 cm | 30 cm | 23 cm | Shaga |
| 15 | Mekanizën palosje automatike | po | jo | | Shaga |

Duhet të kemi parasysh që “veshja e kolltukut” e paraqitur nga operatori Riap-05 nuk ishte lëkurë 100% origjinale por material inkelit. Kjo sjell që ajo veshje, jo vetëm si material kryesor në përbërjen e kolltukut që nuk është në përputhje me specifikimet e vendosura në dokumentat e tenderit, por edhe të amortizohet shumë shpejt dhe të cahet duke dalë jashtë funksionit. Operatori “Shaga” sh.p.k këtë pikë e ka respektuar 100% dhe për më tepër ka vendosur në dispozicion dhe katalogun e lëkurëve me ngjyra të ndryshme që autoriteti kontraktor të zgjedhi midis tyre më një cilësi lëkure 100% origjinale. Produktet që ka ofertuar shoqëria “Shaga” sh.p.k janë produkte importi dhe afati i vendosur në dispozicion nga AK nga momenti i njoftimit për dorëzimin e mostrës, që ishte vetëm “dy ditë pune”, e bënte të pamundur realizimin e produktit edhe sikur të ishte prodhim i brendshëm, pavarësisht kapaciteteve, jo më të porositej dhe prodhohej në përputhje të plotë me specifikimet teknike të

kërkuara nga kompani të huaja. Nisur prej saj, ne dorëzuar një nga mostrat që kemi gjendje në ekspozitë, e cila edhe në vlerësimin dhe matjen e bërë nga KVO, rezulton të jetë mostra më e përafërt, pothuaj identike, me atë të kërkuar nga AK, me disa devijime shume të vogla dhe të parëndësishme, që nuk çënojnë cilësinë e produktit dhe përmbushjen e specifikimeve të përcaktuara në DST, duke u ndodhur në kushtet lejuese që përcakton edhe neni 53, pika 4 e LPP-së, që cituam më lart.

Theksojmë që mostra e dorëzuar nga shoqëria Riap-05 nuk duhet të merret fare parasysh për faktin se personi që e dorëzoi ishte i palegjitimuar për të kryer veprime për këtë procedurë dhe ta dorëzonte atë.

Ne si kompani, në momentin e lidhjes së kontratës, marrim përsipër të dorëzojmë produktin 100% në përputhje me specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga AK, duke vendosur në të edhe sistemin e palosjes, që është një kriter kombëtar dhe ndërkombëtar i përcaktuar për produktin që prokurohet dhe me rëndësinë dhe qëllimin e përdorimit për institucionin ku do të vendoset.

Sa shpjeguam më lart, pretendimi i KVO-së është i padrejtë dhe tendencioz, sepse mjafton të kontrollohet mostra e dorëzuar nga ana jonë, duke vërtetuar kështu që ky kriter është plotësuar në mënyrën më të mirë të mundshme nga shoqëria "Shaga" sh.p.k.

Nuk bën sens dhe është kompromentuese kualifikimi i shoqërisë "Riap-05" sh.p.k në këtë procedurë dhe skualifikimi i ofertës së dorëzuar nga ana jonë.

- Kur mostra e dorëzuar prej shoqërisë "Shaga" sh.p.k përputhet 90% me kriteret e përcaktuara nga AK, ndërsa
- Mostra e dorëzuar nga shoqëria "Riap-05" sh.p.k përmbush kriteret më pak se 30% në përputhje me kriteret e përcaktuara nga AK në DST.

Theksojmë mbi të gjitha se shoqëria "Shaga" sh.p.k ka dorëzuar edhe ofertën më të mirë ekonomike për këtë procedurë. Pra oferta jonë ka qënë edhe oferta më e mirë ekonomike, e dorëzuar nga të gjithë OE që kanë konkuruar për këtë procedurë. Në dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria "Shaga" sh.p.k vërtetohet që shoqëria jonë i ka të gjitha kapacitetet, qoftë ekonomike, qoftë teknike për të realizuar këtë kontratë dhe shumë më tepër se kaq.

Oferta e dorëzuar nga shoqëria "Riap-05" sh.p.k është edhe oferta më e lartë ekonomike që është dorëzuar në këtë procedurë prokurimi, dhe përzgjedhja e saj si ofertë fituese, ndër të tjera rëndon edhe ekonomikisht, financiarisht shtetin.

Përsa argumentuar më lart, vërtetohet se KVO-ja nuk ka bërë vlerësimin e drejtë dhe korrekt sipas ligjit, kur ka skualifikuar ofertën e dorëzuar nga ana jonë me një pretendim të pabazë dhe të pambështetur në aktet ligjore apo në prova, duke mohuar dorëzimin e mostrës në përputhje me specifikimet teknike dhe kriterëve të vendosura në DST, e cila është dorëzuar në përputhje me të gjitha kriteret e vendosura. KVO në mënyrë të padrejtë ka kualifikuar subjektin "RIAP-05" sh.p.k, mostra e dorëzuar prej të cilit nuk plotëson as 30% të kriterëve të vendosura nga AK, dhe ka skualifikuar ofertën e shoqërisë "Shaga" sh.p.k, kur mostra e dorëzuar prej nesh është në përputhje 90% me kriteret e vendosura nga AK.

Përfundimisht, duke u bazuar edhe në faktet dhe provat të cilat janë dokumentat që ne kemi dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimeve dhe mostra fizike lehtësisht e konstatueshme dhe vlerësueshme e dorëzuar në adresën e AK sipas përcaktimeve në DST, që vërtetojnë me fakte në mënyrë të pakundështueshme që ne si operator ekonomik i kemi plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në DST, kërkojmë prej jush si më poshtë:

- Të merrni në konsideratë argumentat e paraqitura nga ana jonë dhe të bëni anulimin e vlerësimit të bërë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe gjithashtu
- Të ribëni klasifikimin e ri, duke shpallur ofertën tonë si ofertë fituese që i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe me vlerën më të mirë ekonomike të ofertuar.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.8106/4 prot., datë 13.09.2018 me objekt: “Kthim përgjigje në lidhje me ankesën për tenderin me objekt: “Mobilimi i sallës së Teatrit Bylis Fier”, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke refuzuar ankesën si vijon:

“[...] Referuar pretendimeve tuaja që ju e vlerësoni të padrejtë skualifikimin dhe konkretisht, referuar ankesës suaj:

1. Ju vlerësoni të padrejtë skualifikimin lidhur me njoftimin për paraqitje mostre në datën 27.08.2018, duke mosrespektuar afatin minimal prej 10 ditësh, ju sqarojmë se ankesa juaj duhet të ishte bërë në momentin e marrjes së mesazhit elektronik në sistem. Paraqitja juaj në ditën e kërkuar është tregues i pranimit të afatit të venosur nga AK.

Gjithashtu ju keni ankimuar skualifikimin, pasi e vlerësoni të padrejtë, për arsye se: “Veshja me multistate e shpinores dhe ulesës dhe trashësia e mbështetëses me 4 cm më shumë, dhe mbi të gjitha që janë lehtësisht të rregullueshme, nuk ndikojnë aspak në cilësinë dhe përdorimin e produktit që kërkohet të dorëzohet.”

Nga verifikimi i mostrave të sjellë nga subjekti “Shaga” sh.p.k dhe “Riap-05” sh.p.k rezulton se të dy subjektet kanë shmangie nga kërkesat e autoritetit kontraktor. Referuar specifikimeve teknike, është hartuar tabela krahasuese si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi i përmasës | Shaga | Riap-05 | AK | Rezultati/ |
|-----|----------------------------|------------------|--------------------|------------------|------------|
| | | Vlera | Vlera | Vlera sipas DST, | |
| 1 | Gjërësia e shpinores | 45 cm | 44 cm | 58 cm | Shaga |
| 2 | Gjërësia e krahëve | 9.2 cm | 8 cm | 9 cm | Shaga |
| 3 | Lartësia dysheme-krah | 59 cm | 62.5 cm | 61 cm | Shaga |
| 4 | Veshje lëkure | Inkelit | Inkelit | Lëkurë | Asnjëra |
| 5 | Veshje multistate shpinore | Veshje me lëkurë | Multistrade | Multistrade | Riap-05 |
| 6 | Këmba hekur | Po | Po | Po | Të dyja |
| 7 | Lartësia e mbështetëses | 70 cm | 75 cm | 76 cm | Riap-05 |
| 8 | Trashësia e mbështetëses | 9 cm | 10 cm | 13.2 cm | Riap-05 |
| 9 | Gjërësia e ulesës | 45 cm | 42 cm | 44 cm | Shaga |
| 10 | Gjërësia totale | 54 cm | 65 cm | 72 cm | Riap-05 |
| 11 | Veshje e ulsës | 4 cm plastik | 0.8 cm multistrade | Multistrade | Riap-05 |
| 12 | Trashësia e ulesës | 9 cm | 16 cm | 12 cm | Shaga |
| 13 | Lartësia dysheme-ulëse | 43 cm | 46 cm | 46 cm | Riap-05 |
| 14 | Gjërësia e këmbës metalike | 30 cm | 30 cm | 23 cm | Të dyja |
| 15 | Mekanizën palosje | po | po | | Të dyja |

II.5. Në datën 21.09.2018 operatori ekonomik “Shaga” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar argumentat e dhëna nga KVO-ja dhe KSHA-ja lidhur me skualifikimin e tij.

II. 6. Në datën 02.10.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1519/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 8963 prot., datë 01.10.2018 me objekt: “Dërgim informacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Mobilim i sallës së Teatrit Bylis Fier””, bashkëlidhur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Shaga” sh.p.k se: “Oferta refuzohet pasi, bazuar ne procesverbalin nr 7132/5 date 29.08.2018, mostrat e paraqitura nga ana juaj nuk perputhen me kerkesat e Autoritetit Kontraktor dhe ne baze te specifikimeve teknike te kontrolluara nga komisioni oferta juaj nuk eshte shpallur fituese”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

Shenim :


1. *Operatori ekonomik fitues do te realizoje edhe montimin e te gjithe seteve te kolltuqeve te kerkuara sipas zerave te preventivit ne Teatrin Bylis*
2. *Ne rast se oferta paraqitet nga bashkim operatoresh ekonomike, Shtojca nr.8 e DST (Kriteret e vecanta te kualifikimit) duhet te plotesohet ne perputhje me nenin 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.*
3. *Operatoret ekonomike te suksesshem pas shpalljes se kualifikimit duhet te paraqesin prane komisionit te vleresimit te ofertave nje cope moster (kolltuk) te preventivit te kerkuar.*

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit është parashikuar si më poshtë:

“Specifikimet per setet e kolltuqeve ne sallën e teatrit "BYLIS":

1. *Multistrat te llakuar dhe sfungjer, trashësia është 12mm,*
2. *Çelik i montuar këmbët, trashësi çeliku është 2.2mm, Çeliku përfunduar është me Veshje pluhur ipoksidi ,*
3. *Mbeshtetese e krahut me dru ah;*
4. *Mbeshtetsja e shpines eshte shkumë(sfungjer): trashësi është 12cm, Dendësia është 45kgs / m3*
5. *Pas multistrato 12mm ngjyre panje*
6. *Ulesje: trashësi është 12cm,Sfungjer Dendësia është 50kgs / m3;*
7. *Poshte multistrato 12mm ngjyre panje*
8. *Veshje me lëkurë 100% ,Ngjyra Vishnje.”*

III.1.3. Në projektin e mobilimit të sallës së teatrit rezulton se është kërkuar që karriget të plotësojnë parametrat e mëposhtëm:



III.1.4. Sipas ankimesit parametrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor janë përmbushur nga ana e tij si vijon:

| Nr. | Emërtimi i përmasës | Shaga Vlera | AK Specifikimet në DST, Vlera e kërkuar |
|-----|------------------------------|------------------|---|
| 1 | Gjërësia e shpinores | 45 cm | 58 cm |
| 2 | Gjerësia e krahëve | 9.5 cm | 9 cm |
| 3 | Lartësia dysheme-krah | 59 cm | 61 cm |
| 4 | Veshje lëkure | Lëkure | Lëkurë |
| 5 | Veshje multistate shpinore | Veshje me lëkurë | Multistrade |
| 6 | Këmba hekur | Po | Po |
| 7 | Lartësia e mbështetëses | 70 cm | 45 cm |
| 8 | Trashësia e mbështetëses | 9 cm | 13.2 cm |
| 9 | Gjërësia e ulësës | 45 cm | 44 cm |
| 10 | Gjërësia totale | 54 cm | 72 cm |
| 11 | Veshje e ulësës | 4 cm plastik | Multistrade |
| 12 | Trashësia e ulësës | 13 cm | 13.2 cm |
| 13 | Lartësia dysheme-ulëse | 27 cm | 40 cm |
| 14 | Gjerësia e këmbës metalike | 25 cm | 23 cm |
| 15 | Mekanizën palosje automatike | po | |

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese:

III.1.6. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme,

vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.7. Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pikat 1, 2 dhe 3 thuhet si më poshtë:

“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.”

III.1.8. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 1, thuhet se:

“Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

III.1.9. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nëpërmjet informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe ankimuesi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit nuk plotëson disa nga treguesit e karrigeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, fakt i cili është pranuar edhe nga shoqëria “Shaga” sh.p.k, parashtruar hollësisht në pikën III.1.4. të arsyetimit.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.12. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentat e procedurës së prokurimit me Nr.REF-80916-07-27-2018 me objekt: “Mobilim i sallës së Teatrit Bylis Fier”, me fond limit 7 499 600 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier, është vendosur kushti që *operatorët ekonomike të suksesshem pas shpalljes së kualifikimit duhet të paraqesin pranë komisionit të vlerësimit të ofertave një cope master (kolltuk) të preventivit të kerkuar*. Në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me këtë kërkesë, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, përsa i përket shoqërisë “Riap-05” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues “Shaga” sh.p.k. pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, ky i fundit nuk gëzon më interes të ligjshëm në përputhje me pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi pozitat e këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi nuk do të ndryshonin.

III.2.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

III.2.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Giithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët se operatori për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për këtë operator me ofertë më të madhe, referuar vlerës ekonomike. Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me operatorin ekonomik “Riap-05” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shaga” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-80916-07-27-2018 me objekt: “Mobilim i salles se Teatrit Bylis Fier”, me fond limit 7 499 600 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 09.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1519 Protokoli,

Datë 21.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha